



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Në bazë të nenit 8, pika 3 nënpika 3.2 të Rregulloren MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe në bazë të nenit 8 pika 5 nëpika 5.2 të Rregullores (KKV) nr.01/2018 për pëcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridik-OJQ-ve dhe ndihmë momentale personave fizik, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Për përzgjedhjen e dy anëtarëve, si anëtarë të Komisionit vlerësues, të cilët kanë për detyrë të vlerësojnë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike për financimin e projekteve të personave juridik - OJQ-ve, në vlerë mbi 500.00€, nga fusha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kandidatët duhet të kenë përvojë dhe të jenë ekspert nga ndonjëra fushë e kulturës, rinisë apo sportit.

1. Përfaqësues nga OJQ-të (një anëtar);
2. Ekspert në vlerësimin projekteve (një anëtar).

Kandidatët duhet të kenë përvojë në fushën e kulturës, rinisë apo sportit.


Përfaqësuesit e lartcekur do të jenë anëtarë të komisionit për vlerësimin e projektpropozimeve të organizatave joqeveritare (OJQ).

Të interesuarit për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të ftesës publike:

1. Të kenë përvojë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
2. T'i njohin metodologjitë vlerësuese në komisione të ngjashme;
3. Të kenë njohuri rreth dokumenteve të tjera relevante në fushën, për të cilën është hapur ftesa publike;
4. Njohje e legjislacioni në fushën e mbështetjes financiare. Periudha e angazhimit do të jetë sipas afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren MF – Nr.- 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Afati për aplikim është 7 ditë kalendarike, nga data 21.03.2024 deri më 28.03.2024, në orën 16.00. Alikacionet së bashku me CV dhe dokumentacion mbështetës dorëzohen në zyrën pritëse të Komunës së Vushtrrisë dhe adresohen në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Vushtrri, 21.03.2024



Drejtoresha e DKRS-së
Medina Bunjaku